

DREJTËSIA

DITARI MUJOR

CEREMONIA E 10 VJETORIT TË THEMELIT TË DHOMËS KOMBËTARE TË NDËRMJETËSUESVE



Ministri Manja ishte i pranishëm në Ceremoninë e 10-vjetorit të themelimit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësuesve. Një dekadë më parë, themelimi i kësaj Dhome ishte një hap vizionar drejt nxitjes së një kulture ndërmjetësimi, si një dëshmi e qartë e fuqisë së komunikimit. Ndryshimet ligjore që solli reforma në drejtësi lehtësuan zbatimin e ndërmjetësimit si një mekanizëm i besueshëm për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. Aktualisht, regjistri i ndërmjetësve numëron rreth 110 ndërmjetës, të cilët ushtrojnë në mënyrë aktive këtë profesion. Manja falenderoi Agjencinë Austriake për Zhvillim për mbështetjen e veçantë nëpërmjet projektit “Zgjerimi dhe Fuqizimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri” dhe u shpreh se detyra e të gjithëve ne është ta forcojmë dhe të besojmë tek mekanizmat e ndërmjetësimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

LEXO PËR MË SHUMË

NË TEPELENË BASHKË ME DREJTORIN E PËRGJITHSHËM TË BURGJEVE NË ANALIZËN MUJORE TË IEVP NË BËNÇË

LEXO PËR MË SHUMË

Ministri Manja bashkë me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve Z. Abrija morë pjesë në analizën mujore të IEVP në Bënçë! Manja i përgëzoi punonjësit dhe titullarët e kësaj IEVP për punën e mirë dhe mbajti shënim shqetësimit e problematikat që ata hasin në punën e përditshme, çka kërkon mbështetjen e pakursyer të DPB! Etemi, Shefi i Policisë, punonjës në policinë e burgjeve prej 24 vitesh, i shprehu mirënjohjen Ministrit Manja, në emër të kolegëve të tij për rritjen e pagave dhe trajtimin dinjitoz.



TAKIM ME Z.MAURO PALMA - KRYETAR I AUTORITETIT GARANTUES PËR TË DREJTAT E TË BURGOSURVE DHE PERSONAVE TË PRIVUAR NGALIRIA

LEXO PËR MË SHUMË



Ministri Manja takon z. Mauro Palma - Kryetar i Autoritetit Garantues për të drejtat e të burgosurve dhe personave të privuar nga liria. I shoqëruar nga Avokat i Popullit znj. Erinda Ballanca dhe ekspertët e të dy palëve, diskutuan për gjendjen e IEVP-ve në Shqipëri dhe garantimin e standardeve evropiane në trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në Shqipëri! Manja shprehu se roli dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit janë udhërrëfyes i rëndësishëm për sistemin tonë të ekzekutimit të vendimeve penale, si një garanci shtesë për respektimin e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve në Shqipëri dhe përshëndti marrëveshjen që Avokati i Popullit nënshkroi me z. Palma, ku përfitues është Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

PREZANTOHET DREJTORESHA E RE E INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMEVE TË VENDIMEVE PENALE ALI DEMI, ZNJ. LINDJANA LAÇI

Ministri Manja bashkë me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, z. Admir Abrija, prezantuan Drejtoreshën e re të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Ali Demi, znj. Lindjana Laçi, e cila do të çojë përpara vizionin që Ministria e Drejtësisë ka për këtë IEVP. Z.Manja dhe z.Abrija i uruan suksese znj Laçi-t në detyrën e re. Gjithashtu duke mos munguar falenderime dhe mirënjohje edhe për znj. Elona Demollari, e cila ka dhënë një kontribut shumë të madh dhe ka menaxhuar me sukses IEVP Ali Demi përgjatë këtyre viteve të fundit dhe do t'i bashkohet skuadrës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në një detyrë të re.



LEXO PËR MË SHUMË



KODI I RI PENAL

LEXO PËR MË SHUMË

Qeveria dhe Ministria e Drejtësisë, kanë ndërmarrë një projekt ambicioz i cili është një nga nismat ligjore më të rëndësishme të viteve të fundit! Kodi i ri penal vjen si përgjigje për të gjitha dinamikat ekonomike dhe sociale që ka përjetuar vendi ynë në vitet e fundit. Një reformë e thellë që do t'i përgjigjet sfidave të kohës, që do të depenalizojë disa sjellje dhe kriminalizojë disa të tjera. Manja shprehu: Duhet guxim dhe ndryshim mentaliteti dhe unë, jo vetëm si Ministër Drejtësie dhe por edhe si politikan, do të jem plotësisht i investuar për ta bërë realitet këtë projekt.

Në themel Kodi i ri Penal do të reflektojë bazën tonë kushtetuese, direktivat e BE-së si dhe praktikat më të mira të gjykatës tonë kushtetuese dhe jurisprudencës së gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut. Gjithashtu është publikuar teksti prezantues për projektin e kodit penal (pjesa e përgjithshme), i cili do të jetë i aksesueshëm për të gjithë profesionistët e fushës. Ministri Manja fton të gjithë aktorët dhe ekspertët e interesuar të japin kontributin e tyre në këtë reformë kaq të rëndësishme juridike dhe politike, i cili do t'i japë fund njëherë e mirë praktikës 28 vjeçare të arnimit të kodit aktual penal.



MANJA ME AVOKATEN E POPULLIT DHE KOMISIONERIN PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË AMBJENTET E RINOVUARA TË QENDRËS PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN NË KAVAJË

Ministri Manja bashkë me Avokaten e Popullit dhe Komisionerin për të Drejtat e Njeriut vizituan disa prej ambientet e rinovuara të Qendrës për të Miturit në Konflikt me Ligjin në Kavajë. Manja shprehu lehtësim dhe krenari për këtë inovacion edukativ dhe integruar për të miturit, krijimtaria dhe veprat e të cilëve janë një pasqyrë e vërtetë e mundësive të kësaj qendre. Ministri i shprehu falenderime Drejtoreshës dhe stafit për kujdesin dhe përkushtimin e tyre me këta të rinj, duke u krijuar kushte moderne për mësim, aktivitete rekreative, dhe zhvillimin e talenteve, ata u japin një frymë të re dhe shembuj pozitivë për të ndjekur në jetë.

LEXO PËR MË SHUMË



ANALIZË 6-MUJORE E AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË PRONAVE

Përgjatë 2 muajve të fundit, janë arritur të ndiqen me përkushtim dhe t'u shërberbehet rreth 5000 qytetarëve, kryesisht për çështjet për plotësim dokumentacioni dhe informimin mbi procedurat që duhet të ndjekin për pronat e tyre. Agjencia e Trajtimit të Pronave mbetet e hapur dhe në gadishmëri të plotë për të asistuar të gjithë qytetarët në procesin e trajtimit të pronave.

LEXO PËR MË SHUMË

TAKIM ME Z.SADORIN BRUCE G. BERTON, KRYETARI NË DETYRË I PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI

Ministri Manja i uron mirëseardhjen në Shqipëri Z.Sadorin Bruce G.Berton dhe e informon mbi ecurinë e projekteve aktuale, sidomos punën e bërë që në themel me organet e reja të drejtësisë. Ambasadori Berton garanoi bashkëpunimin e tij maksimal, dhe gadishmërinë për projekte e reja me rëndësi strategjike për forcimin e sistemit tonë të Drejtësisë.

LEXO PËR MË SHUMË



Ministria e Drejtësisë
Ulsi Manja



ministria_drejtësisë
ulsi manja



@manja_uls